



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS KLINË

Numri i lëndës: 2024:235314

Datë: 28.03.2025

Numri i dokumentit: 07059670

P.nr.159/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA NË KLINË, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, Gjyqtarja e vetme gjykuese Sabrije Rraci, në çështjen penale kundër të pandehurit, E B nga K rruga „Di B,nr.10, i akuzuar për shkak të kryerjes së veprës penale,Lëndim i rëndë trupor , nga neni 186 par.1 nënpar.1.3 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, PP//II.nr.1220/2024 të datës 12.09.2024, në shqyrtimin fillestar publik të mbajtur me dt.25.02.2025 në praninë e Prokurorit të Shtetit Ramiz Buzhala nga Prokuroria Themelore në Pejë, të pandehurit, E Bmbrojtësi i tij av.Veton Puka, i dëmtuari A B, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar të dt.28.02.2025, ndërsa me datë 27.03.2025, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Kundër:

E B i lindur me dt. në P, tani me banim në K rruga,, Di B,, nr. nga babai F dhe e ëma M e vajzërisë M, ka të kryer shkollën e mesme, beqar, me profesion punëtor në ndërtim, i gjendjes së dobët ekonomike, identifikuar me numër personal,,recidivist, i nacionaliteti shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

I pandehuri: E B

Me datë,19.07.2024 , rreth orës 17:50 min., në rrugën „AZ,, në K pikërisht tek banesat kolektive i shkakton lëndime të rënda trupore me pasoja të përkohshme në shëndet, personi tjetër, këtu të dëmtuarit A B, në atë mënyrë që pas mosmarrëveshjeve praprake mes veti lidhur me parking pasi i pandehuri pretendonte se i dëmtuari ia kishte zënë

rrugën për të hyrë me kamioneten e tij në shtëpi, ditën kritike pasi takohen në rrugë, fillimisht Faruku babai i të pandehurit i kërkon të dëmtuarit të largoj automjetin nga rruga ku ishte i parkuar përkohësisht derisa i dëmtuari ishte duke bartur për në banesën e tij disa bidonë me ujë, pasi biseda mes tyre tensionohet i pandehuri E pa asnjë paralajmërim e sulmon duke e goditur me boks në fytyrë mjekër, duke i shkaktuar plagë mprehtë në kokë dhe mjekër me ç, rast të dëmtuarit A Bi shkakton lëndime të rënda trupore , lëndime të konstatuara dhe të përshkruara hollësisht në ekspertizën mjeko-ligjore të dt.30.07.2024 nga eksperti mjeko ligjor të Dr.N H.

me qka ka kryer veprë penale “Lëndim i rëndë trupor ,, nga neni 186 par.1 nënpar.1.3 të KPRK-së.

Prandaj gjykata në bazë të neneve 4, 7 , 17, 38, 43, 40 pika 1.3, 69 dhe 70 dhe neni 183 par.1, neni 366 par. 1 të të KPRK-së, si dhe nenit 364 të KPPRK-së:

GJYKON

I.Me dënim Burgu në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj, me pëlqimin e të pandehurit dënimi i shqiptuar me burgim prej gjashtë (6) muaj, i zëvendësohet me dënim me gjobë në shumë prej një mijë (1000) €, të cilën shumë obligohet ta paguaj, me këste në afat prej tre (3) muaj, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, duke filluar nga data 01 deri me datën 05, të çdo muaj vijues.

Mundësia e pagesës me këste, do të revokohet nëse i pandehuri nuk e paguan këstin me kohë.

II.Nëse i pandehuri nuk dëshiron apo nuk mund ta paguaj gjobën e shqiptuar sipas afatit të dhënë, e njëjta gjobë do të zëvendësohet në dënim me burg, konform nenit 46 par.3 të KPRK-së, ku një ditë burgim do ti llogaritet në 20 uro të gjobës.

III.OBLIGOHET: I pandehuri që në emer të paushallit gjyqësor të paguaj 20 (njëzet) €, dhe tarifën për kompensim të viktimave të krimit shumë në vlerë prej 20 (njëzet) €, të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, pasi aktgjykimi të merrë formën e prerë.

IV.UDHËZOHET: Pala e dëmtuar, AB nga K, rruga,,D B nr. që kërkesën pasurore juridike ta realizojë në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

1.Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Pejë- Departamenti i Përgjithshëm, pranë kësaj Gjykate ka paraqitur aktakuzën, me shenjën PP/II.nr.1220/2024 të datës 12.09.2024, ndaj të pandehurit, E B, nga K Rr. „Di B” nr. dhe mbrojtësit të tij av. Veton Puka, i akuzuar për shkak të kryerjes së veprës penale, Lëndim i Rëndë trupor, nga neni 186 par.1 nënpar.1.3 të KPRK-së.

Gjykata mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me dt.28.02.2025, gjatë të cilës u dëgjuan Prokurori i Shtetit, Ramiz Buzhala i akuzuari E B dhe mbrojtësi av. Veton Puka si dhe pala e dëmtuar A B.

Pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i shtetit, i pandehuri pas konsultimit paraprak të mbrojtësit të tij, ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale që i vihej në barre, me vie keq për këtë që kam bërë, dhe i njëjti deklaroi se shpreh pendesë për veprën penale të kryer, po ashtu ditën kritike kur ka ndodhë ngjarja unë e kam parë nënën se i ka ra të fikët, pastaj e kam godit të dëmtuarin nuk e kam ditë ku jam kur e kam pa nënën në atë gjendje rasti ka ndodhë në afekt pasi që më parë nuk kemi pas asnjë të keqe mes veti, po ashtu kërkojë falje publike në këtë seancë këtu të dëmtuarit për veprën e kryer.

Gjykata kërkon mendimin e prokurorit të shtetit dhe mbrojtësit të pandehurit av. Veton Puka lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.

Prokurori i Shtetit ka deklaruar se pasi që i pandehuri pranoi fajësinë dhe ky pranim i fajësisë është bërë me vullnet të lirë dhe pa presion, duke u mbështetur në provat materiale që gjenden në shkresën të lënda. I propozoj gjykatës që të pranoi pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit për veprën penale që i vihet në barrë, dhe me rastin e marrjes së vendimit, lidhur me dënim, pranimin e fajësisë ta vlerësoj si rrethanë lehtësuese.

Po ashtu edhe mbrojtësi i të pandehurit av. Veton Puka ka deklaruar se pas konsultimit paraprak me të mbrojturin tim, kërkoi nga Gjykata që të ketë lehtësira, me rastin e marrjes së vendimit, ku dhe ja dërgova gjykatës me shkrim një parashtresë për individualizimin e dënimit dhe marrjen parasysh të rrethanave lehtësuese. I cili në

parashtrësë ka kërkuar që akti i pranimit të fajit, ku i mbrojturi im I njëjti ka shprehur keqardhje dhe këtë e ka bërë qysh në fillim, në stacionin Policor në Klinikë enë PTH në Pejë, ashtu që pranimi i hershëm i fajit ka më shumë peshë se sa që ai që vjen më vonë. I pandehuri ka vepruar me tronditje emocionale pasi e ka parë nënën që i ka rënë të fikët pas fjalosjes. Sjellja e të pandehurit pas kryerjes së veprës penale, mosha e re i cili është 19 vjeçar.

I pandehuri kërkoi nga Gjykata që ti shqiptoi një dënim më të butë pasi që nuk kamë qenë i dënuar më parë, dhe nuk është zhvilluar ndonjë procedurë ndaj meje si dhe kamë gjendjen e dobët ekonomike, jam mbajtës i familjes.

2. Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, gjykata, pas dëgjimit të palëve, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar fajësinë nga i akuzuari i lartcekur, për veprën penale për të cilën është ngarkuar, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore nga neni 242 të KPPK-së. Në këtë aspekt gjykata, ka konstatuar se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe pas njoftimit nga ana e gjykatës lidhur me benifitet dhe pasojat e pranimit të fajësisë, ka vlerësuar se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

I dëmtuari A B kërkoi ndjekje penale. Ndërsa sa i përket kërkesës pasurore juridike hjeqi dorë.

3. Gjendja faktike e vërtetuar:

Andaj duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, gjykata, e ka vërtetuar këtë gjendje faktike: Se i akuzuari, ka kryer veprën penale, Lëndim i lehtë trupor nga neni 186 par.1.3 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

4. Vendimi për shpalljen fajtor

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart, gjykata, ka vendosur që të akuzuarin, t'a shpall fajtor për kryerjen e veprave penale sipas aktakuzës së cekur më lart, meqenëse

është vërtetuar se i njëjti e ka kryer veprën penale siç edhe vet e ka pranuar sikurse në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar sikurse në dispozitiv të aktgjykimit dhe për të njëjtën është përgjegjës. Kjo për faktin se e ka pranuar edhe vet.

5. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit:

Me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të akuzuarës Gjykata, i ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, sipas neneve 69 dhe 70 të KPK-së.

Në këtë aspekt, si rrethanë lehtësuese, mbi bazën e së cilës gjykata e ka shqiptuar dënimin për veprën penale sikurse më lart, është fakti se i akuzuari e ka pranuar fajësinë në shqyrtimin fillestar, dhe pendimin e tij, padënueshmërinë e tij më parë, si rrethanë tjetër lehtësuese gjykata muar se ngjarja ka ndodh në afekt pra aty për aty, pastaj moshën e re, rehabilitimin pas kryerjes së veprës penale, ashtu që gjykatës i ka premtuar se nuk do ta përsërisë më vepra penale. Ndërsa, gjykata si rrethanë rënduese gjeti dashjen e kryerjes së veprës penale.

6. Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar.

Dënimi me burgim iu shqiptua në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj burgim, me pëlqimin e të pandehurit iu zëvendësuar në dënim me gjobë në shumën prej njëmijë (1000) euro, e cila gjobë do të ekzekutohet në afat prej 3 muaj nga dita e plotëfuqishmëris së këtij aktgjykimi.

Andaj duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejt, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit.

Gjykata ka konstatuar se me këto dënime mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 38 i KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, por edhe (për mundësinë që të kthehet në një element kontribues për vete, familjen dhe për rrethin ku jeton) të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi për shpenzimet e procedurës dhe paushallit gjyqësor është i bazuar në nenin 449 par. 2 pika 2.6 të KPPK-së, ndërkaq vendimi për pagesën në Fondin për Kompensimin e Viktimave të Krimet është i bazuar në nenin 36 par. 3 nënpar. 3.1 të LKVK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë e në bazë të neneve 242 dhe nenit 364 dhe KPPRK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata Themelore në Pejë-Dega në Klinë.

Departamenti i Përgjithshëm

P.nr.159/2024 me datë 28.03.2025

Bashkëpunatore Profesionale

Fatmire Elezaj

Gjyqtarja

Sabrije Rraci

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë te drejte te parashtrojnë ankesë në afat prej 30 ditësh, nga dita e marrjes. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.